

UDHËZIM
PËR POLITIKËN E VLERËSIMIT NË DISTANCË
NË UST

Në në zbatim të nenit 3, 38, 46, 52, 103, të Ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe të Statutit të UST-se, për shkak të gjendjes së fatkeqësisë natyrore të shkaktuar nga pandemia e COVID-19:

UDHËZOJME:

1. Vlerësimi i arritjeve akademike lëndore dhe i detyrimeve përmbyllëse në distancë të kryeht sipas dokumentit “Politika e vlerësimit në distancë në UST , Lidhja 1, bashkëngjitur.
2. Ngarkohen njësitë kryesore, njësitë bazë, pedagogët dhe administrata e UST-se të zbatojnë këtë udhëzim.

Rektori

Prof. Dr. Agron Kasa

POLITIKA E VLERËSIMIT NË DISTANCË NË UST

Qëllimi i këtij dokumenti është të përcaktojë politikën institucionale mbështetëse për realizimin e vlerësimit në distancë në kushtet e mësimin në distancë për shkak të pandemisë COVID-19. Kjo politikë përcakton parimet dhe format e vlerësimit në distancë të arritjeve të studentëve duke garantuar që studentët e UST-se mund të përfundojnë studimet e tyre, pavarësisht kushteve të vështira të krijuara për shkak të pandemisë së shkaktuar nga COVID-19.

I. PARIME TË VLERËSIMIT NË DISTANCË

1. Vlerësimi bazohet në rezultatet e pritshme të të nxënit të përcaktuara për secilën lëndë.
2. Përzgjedhja e formës/formave të vlerësimit bëhet duke mbajtur parasysh specifikat e lëndës mësimore, qëllimit të vlerësimit, mundësitë e studentit.
3. Detyrat për vlerësim ndërtohen bazuar në taksonominë e rishikuar të Bloom për objektivat në fushën e njohjes. Shih tabela 1 në këtë udhëzim.

4. Kombinohet vlerësimi formues me vlerësimin përmbledhës.

Vlerësimi formues si vlerësim për të nxënit, është vlerësim i një shkalle të vogël, është afatshkurtër dhe jep informacion për progresin e të nxënit të studentëve, përdoret për të përmirësuar të nxënit, nxit fidbekun për progresin e të nxënit, nxit reflektimin aktiv, krijon evidencë për vlerësimin përmbledhës. Pedagogët do të përdorin vlerësimin formues për të krijuar evidencën sesi studentët po përparojnë në të nxënit e tyre dhe do t'u japin fidbek studentëve për të mbështetur të nxënit e tyre.

Vlerësimi përmbledhës, si një vlerësim i të nxënit, ka për qëllim sigurimin e informatave mbi arritjen e rezultatave të të nxënit të lëndës, në fund të periudhave mësimore dhe në fund të vitit akademik. Ky lloj vlerësimi duhet të marrë gjithësi parasysh edhe informatat e mbledhura nga vlerësimi formues.

5. Kombinohet vlerësimi me vetëvlerësimin
6. Vlerësimi autentik përdoret për të vlerësuar aftësitë e studentëve për të zgjidhur detyra nga jeta reale.
7. Zbatohet transparenca e kritereve të vlerësimit për studentët.

Përcaktohen standardet për detyrat dhe kriteret e vlerësimit dhe i bëhen të ditura studentëve.

8. Respektohet ndershmëria akademike

Respektimi i ndershmërisë akademike është një parim i rëndësishëm gjatë mësimit në distancë. Kërkohej që format e përdorura të vlerësimit të minimizojnë mundësinë e kopjimit, mashtrimit dhe të bashkëpunimit të palejuar ndërmjet studentëve.

9. Tregohet kujdes për kategoritë vulnerabël të studentëve

Studentët të cilët, si rezultat i sëmundjes, karantinës, ose ndonjë situatë tjetër personale ose familjare që është rrjedhojë e pandeminë e COVID-19, nuk janë në gjendje të plotësojnë të gjitha detyrimet e lëndëve, do të mbështeten duke iu dhënë një mundësi e dytë.

FORMA TË VLERËSIMIT NË DISTANCË PËR ARRITJET LËNDORE DHE DETYRIMET PËRMBYLLËSE - UDHËZIME PËR PEDAGOGËT

A. PROVIMI ME GOJË ONLINE PËR 15 MINUTA PËR ÇDO STUDENT NËPËRMJET VIDEOKONFERENCËS NË NJË PLATFORMË DIGJITALE. PROCEDURA E PROVIMEVE ONLINE ME GOJË REGJISTROHET.

DREJTIMI I NJË PROVIMI ME GOJË

- 1. Përgatitni studentët tuaj për provimin me gojë online.** Shpjegojuni llojin e pyetjeve dhe procedurën e zhvillimit të provimit online. Bëni grafikun e provimit duke përcaktuar radhën dhe orën e thirrjes në provim online. Informojini studentët se provimi do të regjistrohet.
- 2. Përgatiteni veten për provimin online.** Do të ishte ndihmuese nëse ju vini në provimin me gojë me një numur pyetjesh të parapërgatitura të ndryshme për secilin student. Pyetjet të kenë numra dhe studentët të zgjedhin sipas numrave. Provimi të kufizohet deri në katër pyetje.
- 3. Bëni të pamundurën për të qetësuar studentin.** Studentëve ju duken provimet me gojë shumë stresuese dhe kjo e përmirëson besimin dhe rrjedhshmërinë nëse ata përshëndeten me mirësi dhe mirëpritjen në fillim të provimit me gojë.

4. **Bëni pyetje të hapura që i mundësojnë studentët të japin përgjigje të plota dhe të qarta.** Përpikuni të shmangni pyetjet që të çojnë në përgjigje minimale ose me "po" dhe "jo".
5. **Lejoni studentët të flasin pjesën më të madhe të kohës.** Roli i vlerësuesit në një provim me gojë është të nxisë mendimin dhe të ndihmojë studentët që të flasin rrjedhshëm për punën ose çështjen në diskutim dhe të ndezë një dialog intelektual. Ai nuk është për të kapur ose për të treguar inteligjencën e vlerësuesit, ose për të ngritur kurthe për studentët!
6. **Jepuni studentëve feedback për provimin e tyre.** Ndonjëherë mund të jetë e domosdoshme që grupi i vlerësimit të bëjë një diskutim të shkurtër privat për të arritur një vendim ose për të verifikuar se ajo që mendon secili është një përfundim dhe është unanim. Jepeni vlerësimin drejtpërdrejt.

PËRPILIMI I PYETJEVE TË PROVIMEVE

1. **Përpiloni pyetje që kërkojnë të zbulojnë çfarë kanë nxënë studentët, sesa çfarë ju është mësuar atyre.** Shmangni provën e të kujtuarit të informacionit bazë dhe përpikuni të përpiloni pyetje që u kërkojnë studentëve të përdorin njohuritë e tyre si dhe t'i riinterpretojnë ato në mënyrë inteligjente.
2. **Përdorni gjuhë të thjeshtë.** Studentët duhet të përballojnë stresin e kushteve të provimit online.
3. **Bëjini pyetjet të njëkuptimta.** Shumë studentë mbeten në provime, sepse ata nuk kuptojnë pyetjen dhe nuk ndjekin udhëzimet për numurin e pyetjeve dhe gjatësinë e përgjigjeve, sesa nga mungesa e njohurive.
4. **Shmangni pyetjet për të kapur.** Të tilla pyetje synojnë të tregojnë zgjuarësinë e vlerësuesit sesa vlerën e studentëve. Provimet gjithmonë synojnë të testojnë aftësitë në mënyrë të drejtë, sesa të bëjnë lojra me studentët.
5. **Mbani parasysh t'u prezantoni studentëve kriteret për vlerësimin paraprakisht.** Ata duhet të dinë se cilat janë kriteret e vlerësimit që të organizojnë përgjigjen brenda kohës së parashikuar.
6. **Mos pritni që studentët të flasin gjatë.** Orientojeni studentin në thelbin e pyetjes.
7. **Mbani parasysh se shumë studentë kanë vështirësi në komunikimin me gojë.** Lehtësojeni komunikimin.

B. TEST ME SHKRIM ME PYETJE TË TIPIT OBJEKTIV DHE SUBJEKTIV NËPËRMJET NJË PLATFORME DIGJITALE QË MUNDËSON PËRDORIMIN E TESTEVE.

HARTIMI I PYETJEVE ME ALTERNATIVA TË SHUMTA

Një pyetje me alternativa të shumta ka tre pjesë kryesore: “trungun” që përcakton kontekstin, “çelësin”, që është alternativa më e mirë ose e saktë dhe “ngatërruesit” që janë alternativa që përmbajnë gabime ose përgjigje të rreme. Sugjerimet e mëposhtme duhet t’ju ndihmojnë për të bërë që tre pjesët e pyetjes me alternativa të shumta të funksionojnë në mënyrë të efektshme.

- 1. Sigurohuni që çelësi të jetë plotësisht korrekt!** Nuk duhet të jetë e mundur që studentët të gjejnë ndonjë gjë gabim ose të diskutueshme në çelës.
- 2. Sigurohuni që çelësi të mos dallohet që është korrekt.** Çelësi nuk duhet të dallohet shpejt duke mbajtur fjalë drejtuese nga trangu ose nuk duhet të jetë shumë i ndryshëm në gjatësi nga alternativat e tjera. Gjithashtu, sigurohuni që ndonjë lidhje gramatikore midis trungut dhe çelësit mos të tregojë çelësin.
- 3. Kujdes me “të përcaktuara” dhe të “papërcaktuara”.** Është në rregull të kesh disa alternativa që përmbajnë fjalë të papërcaktuara siç janë “ndonjëherë, shpesh, zakonisht, rrallë” ose fjalë të përcaktuara si “gjithmonë, kurrë, të gjithë, asnjë”, por nuk është mirë të kombinohen të dy llojet e fjalëve në një pyetje të dhënë, meqenëse alternativat e papërcaktuara ka më shumë mundësi të zgjidhen si korrekte nga çdonjëri që jep përgjigje me hamendje dhe ndoshta janë korrekte!
- 4. Sigurohuni që trangu të japë një detyrë të qartë.** Për shembull, jini i qartë nëse « cili...? » do të thotë “cili njëri..?”, ose “cilët..?” Është më mirë të shmangësh alternativa si “të gjitha këto” ose “asnjë nga këto” Këto kanë tendencë të zgjidhen si të sakta nga studentët që nuk mendojnë thellë për të përcaktuar alternativën më të mirë.
- 5. Kujdes me pyetjet negative.** Për shembull, nëse pyesim “Cila nga këto nuk është e vërtetë?” ose “Cila është një përjashtim nga rregulli?”, bëhet e qartë se është alternativa “e gabuar” që duhet zgjedhur në këto pyetje, sepse studentët janë të mësuar të kërkojnë vetëm përgjigjet korrekte.
- 6. Sigurohuni që në çdo ngatërrues të këtë diçka gabim.** Mbani mend se kur shkruani përgjigjen e feedback-ut për ngatërruesit është e nevojshme të shpjegoni në mënyrë bindese çfarë ishte gabim në të dhe pse çelësi është më i mirë.
- 7. Zgjidhni ngatërrues që përfaqësojnë gabime të mundshme.** Nuk ja vlen një ngatërrues që nuk është përdorur nga asnjë si “korrekt”. Ngatërruesit duhet të jenë aq të besueshëm sa mund t’i zgjedhësh ato.

8. **Kujdes për rastet kur edhe studentët më të mirë zgjedhin një ngatërrues.** Kjo, zakonisht, ndodh kur ata shohin kur diçka nuk shkon te alternativa që ata e mendonin të ishte padiskutim “e saktë” ose “më e mira”. Kjo bëhet më mirë me dorë, duke parë skanuar përgjigjet e një grupi të madh studentësh dhe kur dihet më parë se cilët janë studentët më të aftë.
9. **Fillojeni provimin me pyetje relativisht të drejtperdrejta.** Kjo ndihmon studentët me emocione të futen në rrugë të mirë. Kjo gjë është më e mirë sesa shkaktimi i panikut te studentët duke ju dhënë që në fillim një pyetje të vështirë.
10. **Ndihmoni studentët të zhvillojnë aftësitë e tyre për testimin online. Strëvitini studentët të paktën një herë duke pruar platformën për testin online dhe jepuni këshilla për teknikat më të efektshme për të vepruar me këtë formë provimi.**
11. **Caktoni kohën drejt.** Përcaktoni më parë kohën që do të marrë provimi me test me shkrim online. testi..
12. **Përcaktoni mënyrën e vlerësimit, nëse do të jetë automatike apo.** Gjeni mënyra për të bërë vlerësimin të shpejtë dhe të lehtë.
13. **Jepuni feedback të shpejtë studentëve nëse është e mundur.** Duke qenë se provimi juaj është bërë në kompjuter, mund të jetë paracaktuar që ai të japë pikët në çdo kohë, ose kur studentët kanë mbaruar ose në total gjatë punës. Studentëve mund t’u jepet feedback për alternativat e tyre ose në ekran gjatë punës me testin ose në fund si një faqe e printuar.

DHËNIA E FIDBEKUT PËR PYEJET ME ALTERNATIVA TË SHUMTA

Studentët duan dhe kanë nevojë të dinë pse nuk kanë dhënë përgjigje të sakta. Mbani parasysh sugjerimet e mëposhtme për të dhënë feedback të dobishëm dhe të shpejtë për studentët.

1. **Mendoni për kohën kur do shikohen përgjigjet tuaja.** Për shembll, studentët mund t’i shohin përgjigjet tuaja menjëherë në ekran, pasi kanë zgjedhur një alternativë në kompjuter, ose në përfundim të testit.
2. **Bëni të qartë menjëherë nëse alternativa ishte e saktë ose jo.** Feedbacku i menjëhershëm mund të jetë shumë i dobishëm, veçanërisht kur mund t’u kujtoni studentëve pse kishin të drejtë ose pse ishin gabim.
3. **Jepni vlerësimin e drejtë për zgjedhjen e alternativës së saktë.** Pak fjalë të zgjedhura me kujdes mund të jenë mjaft nxitëse për studentët që bëjnë zgjedhjen e saktë.
4. **Përgjigjuni ndaj studentëve që zgjedhin ngatërruesit.** Është pak e dobishme të thoni thjesht “gabim”, alternativa e duhur ishte “A”. Studentët duan (dhe kanë nevojë) të dinë pse ngatërruesi i tyre nuk ishte alternativa më e mirë. Nëse ju nuk mund të përgjigjeni

për një ngatërrues do të thotë se ai nuk ishte i mirë së pari. Ngatërruesit e mirë janë gabim për një arsye, jo thjesht gabim!

5. **Trajtoni studentët që zgjedhën ngatërruesit me butësi.** Mos i lini të mendojnë që ata duhet të jenë të vetmit që kanë bërë të tilla gabime.
6. **Jepuni mundësi studentëve të japin feedback për feedbackun tuaj.** Kontrolloni në mënyrë të veçantë se kur shpjegoni çfarë ishte gabim në zgjedhjen e ngatërruesve, studentët e kuptojnë qartë mesazhin tuaj.
7. **Mendoni për mënyra vizuale të përgjigjes.** Disa studentë mund të dëshirojnë të përgjigjen në mënyrë vizuale sesa me fjalë - të paktën ndonjëherë. Përpiquni të punoni me një ekspert grafike për kompjuter, kur hartoni përgjigjet për paketën kompjuterike.

C. PROVIMI I KRYER NGA SHTËPIA

Provimi i kryer nga shtëpia është një formë e provimit me libra të hapura, por në këtë rast kryhet në kushtet e shtëpisë. Për këtë lloj detyre të kryer online, zakonisht parashikohet 30-60 minuta më shumë se koha e parashikuar në provimin me libra të hapura. Kjo kohë shtesë parashikohet për veprimet e hyrjes në platformë të shkarkimit dhe të ngarkimit të materialit, të gjetjes së burimeve në internet. Për këtë lloj provimi mund të përdoret një nga këto lloje detyrash:

- Studim rasti
- Ese
- Projekt
- Analizë klinike, dokumenti, evidence, analizë, të dhënash
- Përgatitje platforme
- Përgatitje modeli
- Poster

Provimi i kryer nga shtëpia mat:

- a. aftësinë për të përdorur burime jashtë klase
- b. aftësinë për t'u përqendruar në një fushë qëndrore
- c. aftësinë për të prodhuar një ekstrakt nga një ose disa burime
- d. aftësinë për të paraqitur një mendim profesional
- e. aftësinë për të argumentuar
- f. aftësinë për të gjykuar e vlerësuar
- g. aftësinë për të krijuar
- h. aftësinë për të organizuar përgjigjen

D. DOSJE ELEKTRONIKE E PUNIMEVE TË KURSIT

Dosja elektronike e punimeve përmban një sërë punimesh, por për qëllime të vlerësimit paraqiten dy deri në tre punime që mund të jenë ese, studim rasti, projekt, modele, poster, dokument politikash, video, analizë evidencash, raportesh.

VLERËSIMI I PUNËS LABORATORIKE

Në shumë lëndë mësimore të nxënë të rëndësishëm ndodh në laboratore dhe gjatë seancave praktike. Është e rëndësishme që të vlerësohet me kujdes ky lloj të nxëni. Sugjerimet që vijojnë mund t'i ndihmojnë studentët të realizojnë një punë të tillë.

- 1. Jepuni studentëve udhëzime të qarta për formatin e raporteve të punës në laborator.** Për shembull, publikoni një fletë me titujt kryesorë të përgjithshëm të seksionit, me një përshkrim të shkurtër të qëllimit dhe të natyrës së çdo seksioni kryesor në një raport tipik.
- 2. Vëriuni studentët të vlerësojnë në mënyrë subjektive disa raporte të shkuara.** Pajisini studentët me disa kopje të raporteve të mira, të dobëta dhe mesatare dhe kërkojuni atyre që t'i vlerësojnë në mënyrë të pavarur, thjesht duke i vënë çdo shembull një notë sipas përshtypjes. Pastaj organizoni një diskutim ku studentët të shpjegojnë vlerësimet që kanë bërë.
- 3. Vëriuni studentët të vlerësojnë në mënyrë objektive disa raporte të shkuara.** Pajisini studentët me disa kopje të raporteve të mira, të dobëta dhe mesatare dhe kërkojuni atyre që t'i vlerësojnë në mënyrë të pavarur bazuar në kritere të caktuara dhe në një skemë vlerësimi. Kërkojuni çdo grupi të vlerësojnë raportet. Pastaj inicioni diskutimet dhe krahasimet ndërmjet grupeve.
- 4. Publikoni afatet për paraqitjen e raporteve.** Lini një ose dy javë kohë pas sesionit të laboratorit. Është mirë për studentët t'i shkruajnë ato më parë sesa t'i grumbullojnë ato si të prapambetura, gjë që mund të përplashtet (për shembull) me përsëritjet për provime.
- 5. Mos këmbëngulni për raporte të plota shumë shpejt.** Jepni udhëzime për raportet me formular të shkurtër dhe lejojuni studentët të vlerësohen për tre raporte të plota dhe për gjashtë raporte të shkurtëra të dymbëdhjetë sesioneve laboratorike.
- 6. Përgatisni një vlerësim standard/ një tabelë feedback-u për t'ia kthyer studentëve me raportet e vlerësuara.** Përfshini kriteret dhe notat të shoqëruara me cilësinë e të dhënave, vërtetimet, llogaritjet, përfundimet referencat dhe gjykimet.
- 7. Caktoni punën praktike para sesionit dhe përfshini një parapërgatitje laboratorike të vlerësuar.** Për shembull, paraqisni gjashtë pyetje me përgjigje të shkurtër që studentët t'i përgjigjen para fillimit të një pjese të punës së laboratorit. Kjo i ndihmon studentët të kuptojnë se ç'po bëjnë sesa të ndjekin udhëzimet qorrazi. Kjo shmang, gjithashtu, shpenzimin e kotë të kohës në fillim të sesionit të laboratorit ku studentët janë përgatitur të ndërmarrin çdo eksperiment.

8. **Përfshini në provime disa nga pyetjet që lidhen me punën në laborator.** Për shembull, tregojuni studentëve se dy nga pyetjet do të jenë të lidhura me veprimtarinë e laboratorit.
9. **Mbani parasysh përdorimin e kompjuterave në praktikën laboratorike.** Kur mundësitë ekzistojnë, parashikoni që studentët të fusin të dhënat e provave të tyre drejtpërdrejt në kompjuter ose në rrjet. Shumë universitete tani u krijojnë mundësi studentëve të shkruajnë raportet e tyre duke përdorur një model raporti në disk. Raporte të tilla mund të shpërndahen drejtpërdrejt në përfundim të sesionit të laboratorit, të vlerësohen dhe të kthehen menjëherë.

VLERËSIMI I PUNËS PRAKTIKE

Aftësitë praktike janë të rëndësishme në një sërë lëndësh. Kjo rëndësi reflektohet edhe në kohën që studentët shpenzojnë në labore, atelie, institucione dhe mjedise të tjera ku ata praktikojnë dhe zhvillojnë aftësi të tilla. Megjithatë, ka vlerë të përcaktohet nëse ne i masim këto aftësi drejtpërdrejt apo ne vetëm drejtojmë matjen e produkteve finale të përdorimit të aftësive të tilla. Ngritja e pyetjeve të mëposhtme mund të jetë e dobishme për përpjekjet tona për të gjetur balancën e drejtë. Në rastin e praktikave online, në masin aftësitë e studentëve nëpërmjet produkteve të tyre.

1. **Cilat janë ekzaktësisht aftësitë që ne duam të vlerësojmë?** Këto mund të përfshijnë një gamë të gjerë të aftësive të rëndësishme, nga shkathtësitë për të grupuar enët kimike në laboratorin e kimisë deri në saktësinë dhe shpejtësinë e përdorimit të instrumenteve. Është e rëndësishme që studentët të dinë rëndësinë relative të secilës aftësi.
2. **Pse duhet të masim aftësitë praktike?** Kredibiliteti i kurseve tona shpesh varet nga fakti se çfarë mund të bëjnë studentët tanë kur fillojnë punën. Punëdhënësit thonë shpesh se studentët kanë mjaft njohuri, por nuk janë të aftë në detyrat praktike.
3. **Cili është vendi më i mirë për të matur aftësitë praktike?** Disa herë aftësitë praktike mund të maten në mjedise të tilla si labore ose atelietë. Për aftësi të tjera, studentët duhet të vendosen në situata nga jeta reale.
4. **Kur është koha më e përshtatshme për të matur aftësitë praktike?** Kur aftësitë praktike janë realisht të rëndësishme, është më mirë që matja të fillojë shumë herët në mënyrë që nëse te disa studentë vërehen probleme shqetësuese ata mund të këshillohen dhe riorientohen.
5. **Kush është më mirë të bëjë vlerësimin e aftësive praktike?** Për shumë aftësi praktike, mënyra e vetme e efektshme është që dikush nga personeli ndihmës mund të vëzhgojë demonstrimin e këtyre aftësive. Kjo gjë do t'i merrte kohë personelit pedagogjik dhe do të ishte kërcënuese për studentët.
6. **A është e domosdoshme që të vendosen standardet e pranueshme minimale?** Në shumë profesione, është krejt e domosdoshme që cilido që vepron në praktikë të zotërojë

aftësi në nivel të lartë. Në situata të tjera, është e mundur të bihet dakord për një nivel të arsyeshëm aftësish dhe të ketë siguri të mjaftueshme.

TAB. 1 TAKSONOMIA E BLOOMIT: FORMA TË DETYRAVE PËR VLERËSIM NË FUSHËN E NJOHJES

	Të mbajturit mend	Të kuptuarit	Zbatimi	Analiza	Vlerësimi	Krijimi
Përshkrimi i niveleve	Eksponon të mbajturit mend të materialit të mësuar më parë duke kujtuar fakte, terma, koncepte themelore dhe duke dhënë përgjigje.	Demonstron të kuptuarit e fakteve dhe ideve duke organizuar, krahasuar, transformuar, interpretuar, përshkruar dhe duke deklaruar idetë kryesore.	Zgjidh problemet në situata të reja duke përdorur në një mënyrë tjetër njohuri, fakte, teknika dhe rregulla të përvetësuara më parë.	Shqyrton dhe ndan informacion në pjesë duke identifikuar motivet apo shkaqet. Nxjerr përfundime dhe gjen prova për të mbështetur përgjithësimet.	Prezanton dhe mbron opinione duke bërë gjykime rreth informacionit, vlefshmërisë së ideve, apo cilësisë së punës bazuar në një sërë kriteresh.	Formaton informacionin në një mënyrë të ndryshme duke kombinuar elementet në një model të ri ose duke propozuar zgjidhje alternative.
Forma të vlerësimit online	Teste objektive • me përgjigje alternative, • me alternativa të shumta, • me përgjigje të shkurtër • me plotësim	• Simulime • Animacione • Demonstrim	• Teste objektive me alternativa të shumta • Ese • Simulime • Studim rasti • Zgjidhje problemi • Laborator virtual • Pacient virtual	• Teste objektive me alternativa të shumta • Ese • Projekte • Dosje me punime • Simulime • Prezantime • Analiza evidencash • Analizë të dhënash • Stdutim rasti • Detyrë e kryer me libra të hapura	• Teste objektive me alternativa të shumta • Ese, • Projekte • Dosje me punime • Simulime • Prezantime • Analiza evidencash • Analizë të dhënash • Stdutim rasti • Detyrë e kryer me libra të hapura	• Teste objektive me alternativa të shumta • Ese • Projekte • Dosje me punime • Simulime • Prezantime • Analiza evidencash • Analizë të dhënash • Stdutim rasti • Detyrë e kryer me libra të hapura